

3. Romane me fotografi

kl. 6–9

2–3 orë



Materiali:

Fletat, kamera ose telefon i dorës me kamerë.

«Romane me fotografi» janë të njoitura nga revistat për të rinj. Ato ndërtohen me një tregim me fluska gjuhësore e fotografi. (Ndoshta vijnë edhe elemente të tjera të tekstit, p.sh. një brez nën një foto me komentin «Një javë më vonë...».) Afërsisht si tek krijimi i një fletushke me përbajtje komike, N duhet që së pari të mendojnë një veprim dhe në mënyrë të një skenari ta ndajnë në skena. Fotografitë mund të bëhen (eventualisht në kohën e lirë ose si detyrë shtëpie) me telefon të dorës ose me një kamerë elektronike dhe pastaj të shtypen. N me njojuri të mira të kompjuterit mund të krijojnë tërë romanin me fotografi në mënyrë elektronike.

4. Minibooks

kl. 2–5

30–60 min.



Materiali:

Materiale të paracaktuara (shiko djathtas)

Minibooks (libra të vegjël) janë libërtha të vegjël të bërë vetë, të cilët përbëhen nga një titull dhe 6–7 faqe tekst. Për krijimin e tyre kërkonet një ide për një tregim, një fletë (A4 ose A3) dhe udhëzimi se si ky duhet të paloset ose prehet.

Udhëzimi gjendet p.sh. në <http://www.minibooks.ch/>. Ose e shkarkon M dhe e shpërndan ose N e bëjnë libérthin e tyre drejtpërdrejt në kompjuter, nëse të tillë janë në shfrytëzim. Libérthat duken atraktivë dhe natyrisht mund edhe të ilustrohen.

5. Rugët të vazhdohen

klasat 3–9

Materiali:

Pamje të vendit (kartolina ose fotografi nga revistat).

N marrin një pamje të një treve (p.sh. nga vendi i prejardhjes) dhe e ngjitin mbi një fletë (A4 ose A3 têrthorazi). Ata e ngjyrosin më tutje pamjen e trevës majtas dhe djathjas (eventualisht pjesërisht edhe si detyrë shtëpie). Nën të shkruajnë një tekst për pamjen të cilën ata e pëershruajnë, se si shtegtojnë nëpër këtë trevë dhe çfarë shohin, ndiejnë, nuhatin dhe përjetojnë.